VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE		Aktakuza është HUDHUR, para shqyrtimit gjyqësor	I akuzuari është shpallur FAJTOR	I akuzuari është LIRUAR	Për të akuzuarin është REFUZUAR Aktakuza	Numri personave	% sipas llojit të veprës penale
1	ARMËT	1	33	4		38	1.84%
2	DROGAT	15	819	19	19	872	42.19%
3	KONTRBANDIMI ME MIGRANT	2	78	4	1	85	4.11%
4	KRIMI ORGANIZUAR	11	6		2	19	0.92%
5	KORRUPSIONI	65	397	177	105	744	35.99%
6	SHPËRLARJA E PARASË		2		2	4	0.19%
7	TRAFIKIMI ME QËNJIE NJERZORE	2	76	7	2	87	4.21%
8	KRIMET EKONOMIKE	20	153	12	26	211	10.21%
9	NXITJA URREJTJES		6	1		7	0.34%
Gjithsej		116	1570	224	157	2067	100.00%

Figura 33

PROKURORIA (2013-2017)		Aktakuza është hudhur, para shqyrtimit	I akuzuar është shpallur fajtor	I akuzuari është liruar	Është refuzuar aktakuza	TOTALI:
1	PSRK	14	45	3	5	67
2	PTH. PRISHTINË	34	214	47	57	352
3	PTH. PRIZREN	13	339	80	44	536
4	PTH. PEJË	9	211	18	1	239
5	PTH. GJILAN	13	126	4	3	146
6	PTH. MITROVICË	12	94	16	7	129
7	PTH. FERIZAJ	13	335	25	23	396
8	PTH. GJAKOVË	8	146	31	17	202
Gjithsej		116	1570	224	157	2067

Figura 34



3.3 ANKESAT E PROKURORËVE

Prokurorët për pesë vite (2013-2016) kanë parashtruar në Gjykatën e Apelit gjithsej **478** ankesa, ndaj vendimeve mbi dënimin dhe ankesave për arsyet tjera përveç dënimin, prej të cilave Gjykata e Apelit ka aprovuar **25** ankesa apo **5.23%** (shih figurën 35).


VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE		Ankesat kanë të bëjnë me:		Numri i ankesave	Ankesat e Aprovuara nga Gjykata e Apelit	Përqindja e ankesave të aprovuara nga Gjykata Apelit	Përgjigjja e Prokurorit në ankesën e parashtruar nga pala e akuzuar
		Vendimin mbi dënimin (lartësinë e dënimin)	Arsyet tjera (përveç vendimit mbi dënimin)				
1	ARMËT	10	3	13	3	23.08%	
2	DROGAT	97	49	146	4	2.74%	1
3	KONT. ME MIGRANT	25	8	33	4	12.12%	
4	K. ORGANIZUAR						
5	KORRUPSIONI	125	113	238	13	5.46%	
6	SH. PARASË		1				
7	T. Q. NJERËZORE	21	11	32			
8	EKONOMIKE	9	4	13	1	7.69%	
9	NXITJA URREJTJES	1	2	3			
GJITHSEJ:		288	190	478	25	5.23%	1

Figura 35

Gjykatat e Apelit ka aprovuar gjithsej 25 ankesa, respektivisht kanë aprovuar 8 ankesa të PTh. Prishtinë; 15 të PTh Prizren, 1 të PTh. Ferizaj dhe 1 të PTh. Gjakovë (shih figurën 36).

PROKURORIA (2013-2017)		ANKESA-PROKURORIT		Totali i ankesave	Ankesat e Aprovuara nga Gjykata e Apelit	Përqindja e ankesave të aprovuara nga Gjykata e Apelit	Përgjigjja e Prokurorit në ankesën e parashtruar nga pala e akuzuar
		Vendimet mbi dënimin	Për arsye tjera				
1	PSRK	4	1	5			
2	PRISHTINË	75	31	106	8	7.55%	
3	PRIZREN	78	72	150	15	10%	
4	PEJË	16	12	28			
5	GJILAN	46	13	59			1
6	MITROVICË	25	13	38	1	2.63%	
7	FERIZAJ	30	30	60			
8	GJAKOVË	13	18	32	1	3.13%	
#		288	190	478	25	5.23%	1

Figura 36



PJESA -IV-

- **TRENDI I PROCEDIMIT TË INFORMATAVE “PPN”, TË REJA: 2013-2017**
- **NGARKESA ME INFORMATA “PPN”: 2013-2017**
- **INFORMATAT “PPN” SIPAS PARASHTRUESVE**

4.1 INFORMATAT “PPN”

Prokuroritë gjatë pesë (5) viteve, kanë pranuar **2316** Informata PPN, të reja, për veprat penale karakteristike, ndërsa gjatë të njëjtës periudhë kohore (2013-2017), kanë proceduar **1707** Informata PPN, apo **73.70%** (*shih figurën 37*).

VEPRAT PENALE		2013			2014			2015			2016			2017			Totali:2013-2017		
		Pranuara	Proceduar		Pranuara	Proceduar		Pranuara	Proceduar		Pranuara	Proceduar		Pranuara	Proceduar		Pranuara	Proceduar	
			Nr.	%		Nr	%		Nr	%		Nr	%		Nr	%		Nr	%
1	A	2	0					1	1	100							3	1	33.33
2	DR	13	7	53.85	21	12	57.14	9	2	22.22	30	19	63.33	29	18	62.07	102	58	56.86
3	KM	6	2	33.33	9	1	11.11	8	2	25	1	0		2	1	50	26	6	23.08
4	KO	1	0		9	3	33.33	4	3	75	3	3	100	3	4	133.33	20	13	65
5	KORR	165	81	49.09	183	143	78.14	270	153	56.67	433	274	63.28	446	495	110.99	1497	1146	76.55
6	SHP	30	24	80	14	11	78.57	17	12	70.59	21	6	28.57	19	11	57.89	101	64	63.37
7	TNJ	8	5	62.50	9	4	44.44	11	3	27.27	3	5	166.67	4	6	150	35	23	65.71
8	E				36	12	33.33	110	72	65.45	155	104	67.10	231	208	90.04	532	396	74.44
9	NU																0	0	
		225	119	52.89	281	186	66.19	430	248	57.67	646	411	63.62	734	743	101.23	2316	1707	73.70

Figura 37

Efikasitetin më të lartë në mbylljen e Informatave PPN, për 5 vite (2013-2017), rezulton të ketë PTh. Gjilan (84.47%), ndërsa PTh. Prishtinë përkundër sasisë më të lartë të Informatave PPN, rezulton si prokuroria e dytë me performancën më të lartë në mbylljen e Informatave PPN (84.27%).

Ndësa efikasitetit më të ulët në mbylljen e Informatave PPN rezulton të ketë PTh. Mitrovicë (31.96%) (*shih figurën 38*).

#	PROKURORIA	Informata PPN të pranuar	Informata PPN, të mbyllura	%
1	PTH.GJILAN	103	87	84.47%
2	PTH.PRISHTINË	763	643	84.27%
3	PTH.PRIZREN	160	131	81.86%
4	PTH.GJAKOVË	94	71	75.53%
5	PTH.PEJË	475	346	72.84%
6	PTH.FERIZAJ	367	263	71.66%
7	PSRK	257	135	52.53%
8	PTH.MITROVICË	97	31	31.96%
	GJITHSEJ	2316	1707	73.70%

Figura 38

4.2 NGARKESA ME INFORMATA “PPN”

Ngarkesa me lëndë (*Informata PPN*), për veprat e pretenduara penale karakteristike, duke filluar nga viti 2013 ka pësuar rritje të vazhdueshme deri në fund të vitin 2016, ndërsa në fund të vitit 2017, për herë të parë që nga funksionalizimi i mekanizmit përcjellës, është zvogëluar me **-66** lëndë, në raport me ngarkesën me lëndë (*Informata PPN*), në vitin paraprak (*shih figurën 39*).

#	VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE	2013	Në vitin 2014 kishte +/- lëndë se në vitin 2013	2014	Në vitin 2015 kishte +/- lëndë se në vitin 2014	2015	Në vitin 2016 kishte +/- lëndë se në vitin 2015	2016	Në vitin 2017 kishte +/- lëndë se në vitin 2016	2017
1	ARMËT	4	0	4	0	4	0	4	0	4
2	DROGAT	13	+10	23	+7	30	+12	42	+7	49
3	KONTRAB.ME MIGRANT	6	+9	15	+6	21	-2	19	+1	20
4	KRIMI I ORGANIZUAR	2	+8	10	0	10	+1	11	-1	10
5	KORRUPSIONI	248	+54	302	+97	399	+301	700	-97	603
6	SHPËRLARJA E PARASË	25	+7	32	+3	35	+15	50	+17	67
7	TRAFIKIMI ME NJERËZ	6	+5	11	+9	20	-4	16	-3	13
8	KRIMET EKONOMIKE		+26	26	+39	65	+107	172	+10	182
9	NXITJA URREJTJES									
Gjithsej:		304	+119	423	+161	584	+430	1014	-66	948

Figura 39

Ngarkesa me lëndë (*Informata PPN*), sipas kriterit të prokurorive, në vitin 2017 në raport me vitin 2016, është zvogëluar në Prokuroritë Themelore në Prishtinë (**-52**), Prizren (**-37**), dhe Pejë (**-35**), ndërsa në Gjiilan (**0**), ka mbetur e njëjtë si në vitin 2016 (*shih figurën 40*)

#	PROKURORIA	2013	+/-	2014	+/-	2015	+/-	2016	+/-	2017
1	PSRK	46	+48	94	23	117	20	137	23	160
2	PTH. PRISHTINË	159	-25	134	42	176	336	512	-52	460
3	PTH. PRIZREN	8	+25	33	-3	30	21	51	-37	14
4	PTH. PEJË	20	+18	38	46	84	37	121	-35	86
5	PTH. GJILAN		+13	13	9	22	-8	14	0	14
6	PTH. MITROVICË	30	+9	39	23	62	10	72	12	84
7	PTH. FERIZAJ	30	+32	62	15	77	8	85	18	103
8	PTH. GJAKOVË	11	-1	10	6	16	6	22	5	27
GJITHSEJ:		304	+119	423	+161	584	+430	1014	-66	948

Figura 40

4.3 PERSONAT NË INFORMATAT T “PPN”

Gjatë pesë (5) viteve, objekt të analizës, në prokurori janë pranuar **3773** raste për Persona të përfshirë në Informata/Raporte “PPN” të reja, për veprat e pretenduara penale karakteristike, ndërsa gjatë të njëjtës periudhë kohore (2013-2017), janë mbyllur **2684** rastet për Persona, apo **71.14%** (shih figurën 41).

VEPRAT PENALE		2013			2014			2015			2016			2017			Totali:2013-2017		
		Pranuara	Proceduar		Pranuara	Proceduar		Pranuara	Proceduar		Pranuara	Proceduar		Pranuara	Proceduar		Pranuara	Proceduar	
			Nr.	%		Nr.	%		Nr.	%		Nr.	%		Nr.	%		Nr.	%
1	A	23	0		0	0		1	1	100	0	0		0	0		24	1	4.17
2	DR	21	8	38.10	30	12	40	16	4	25	34	19	55.88	30	26	86.67	131	69	52.67
3	KM	23	4	17.39	22	2	9.09	15	2	13.33	1	1	100	1	1	100	62	10	16.13
4	KO	4	0		24	7	29.17	8	4	50	15	13	86.67	10	10	100	61	34	55.74
5	KORR	331	133	40.18	372	281	75.54	548	336	61.31	705	457	64.82	721	813	112.76	2677	2020	75.46
6	SHP	48	25	52.08	33	20	60.61	37	20	54.05	56	15	26.79	26	18	69.23	200	98	49
7	TNJ	13	6	46.15	12	7	58.33	18	8	44.44	4	7	175	5	7	140	52	35	67.31
8	E	0	0		37	12	32.43	113	74	65.49	165	112	67.88	251	219	87.25	566	417	73.67
9	NU	0	0		0	0		0	0		0	0		0	0		0	0	
		463	176	38.01	530	341	64.34	756	449	59.39	980	624	63.67	1044	1094	104.79	3773	2684	71.14

Figura 41

Efikasitetin më të lartë në mbylljen e rasteve për Persona në Informatat PPN, për 5 vite (2013-2017), rezultojnë të ketë PTh. Prizren (82.42%), ndërsa PTh. Prishtinë përkundër sasisë më të lartë të rasteve për Persona në Informatat PPN, rezultojnë të jetë prokurorija e dytë me performancën më të lartë në mbylljen e rasteve për persona në Informatat PPN (81.34%).

Ndësa efikasitetin më të ulët në mbylljen e rasteve për persona në Informatave PPN rezultojnë të ketë PTh. Mitrovicë (34.06%) (shih figurën 42).

#	PROKURORIA	Personat në Informatat PPN, të pranuar: 2013-2017	Rastet e mbyllura për Persona në Informatat PPN: 2013-2017	%
1	PTh.PRIZREN	256	211	82.42%
2	PTh.PRISHTINË	1254	1020	81.34%
3	PTh.GJILAN	133	106	79.70%
4	PTh.PEJË	659	504	76.48%
5	PTh.GJAKOVË	142	99	69.72%
6	PTh.FERIZAJ	473	314	66.38%
7	PSRK	718	383	53.34%
8	PTh.MITROVICË	138	47	34.06%
GJITHSEJ		3773	2684	71.14%

Figura 42

4.4 NGARKESA ME PERSONA NË INFORMATAT“PPN”

Ngarkesa me persona (në Informatat PPN), për veprat e pretenduara penale karakteristike, duke filluar nga viti 2013 ka pësuar rritje të vazhdueshme deri në fund të vitin 2016, ndërsa në fund të vitit 2017, për herë të parë që nga funksionalizimi i mekanizmit përcjellës, është zvogëluar me **-69 persona**, në raport me ngarkesën me persona (në Informatat PPN), në vitin paraprak (shih figurën 43).

#	VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE	2013	Në vitin 2014 kishte +/- PERSONA se në vitin 2013	2014	Në vitin 2015 kishte +/- PERSONA se në vitin 2014	2015	Në vitin 2016 kishte +/- PERSONA se në vitin 2015	2016	Në vitin 2017 kishte +/- PERSONA se në vitin 2016	2017
1	ARMËT	27	-1	26	0	26	0	26	0	26
2	DROGAT	23	+18	41	+12	53	+15	68	0	68
3	KONTRABANDIMI ME MIGRANT	21	+21	42	+13	55	-4	51	+1	52
4	KRIMI I ORGANIZUAR	6	+22	28	-2	26	+3	29	-1	28
5	KORRUPSIONI	578	+107	685	+166	851	+350	1201	-99	1102
6	SHPËRLARJA E PARASË	45	+20	65	+10	75	+41	116	+16	132
7	TRAFIKIMI ME NJERËZ	13	+5	18	+13	31	-6	25	-5	20
8	KRIMET EKONOMIKE		+28	28	+40	68	+113	181	+19	200
9	NXITJA URREJTJES									
Gjithsej:		713	+220	933	+252	1185	+512	1697	-69	1628

Figura 43

Ngarkesa me **persona** (në Informatat PPN), sipas kriterit të prokurorive, në vitin 2017 në raport me vitin 2016, është zvogëluar në Prokuroritë Themelore në Prishtinë (-66), Prizren (-48), dhe Pejë (-67) (shih figurën 44)

#	PROKURORIA	2013	+/-	2014	+/-	2015	+/-	2016	+/-	2017
1	PSRK	130	141	271	61	332	24	356	36	392
2	PTH. PRISHTINË	408	-70	338	62	400	420	820	-66	754
3	PTH. PRIZREN	15	53	68	-13	55	18	73	-48	25
4	PTH. PEJË	43	19	62	67	129	37	166	-67	99
5	PTH. GJILAN		19	19	15	34	-15	19	4	23
6	PTH. MITROVICË	56	4	60	35	95	13	108	18	126
7	PTH. FERIZAJ	44	55	99	23	122	4	126	35	161
8	PTH. GJAKOVË	17	-1	16	2	18	11	29	19	48
GJITHSEJ:		713	220	933	252	1185	512	1697	-69	1628

Figura 44

4.5 INFORMATAT “PPN”, SIPAS SUBJEKTEVE PARASHTRUESE

Subjektet parashtruese të padive, gjatë pesë viteve (2013-2017) kanë proceduar nëpër prokurori **2316** Informata PPN ndaj **3773** personave, të përfshirë në veprat e pretenduara penale karakteristike të Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional, prej të cilave më së shumti për veprën penale të Korrupsionit, respektivisht 64.64% të totalit të Informatave PPN dhe 70.95% të totali të personave (shih figurën 45).

#	Subjektet parashtruese	A		DG		KM		KO		KORR		SHP		TNJ		E		NU		TOTAL	
		R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P
1	Agjencioni Kundër Korrupsionit	0	0	0	0	0	0	0	0	17	36	2	2	0	0	0	0	0	0	19	38
2	Agjencioni Kosovar i Pronës	0	0	0	0	0	0	0	0	1	4	0	0	0	0	0	0	0	0	1	4
3	Autoriteti Pyjor i Kosovës	0	0	0	0	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	1	1
4	Administrata Tatimore Kosovës	0	0	0	0	0	0	1	3	2	9	0	0	0	0	24	24	0	0	27	36
5	Dogana e Kosovës	0	0	0	0	0	0	1	4	2	2	4	5	0	0	31	32	0	0	38	43
6	EULEX-i	0	0	0	0	0	0	0	0	220	443	0	0	0	0	0	0	0	0	220	443
7	I Dëmtuari	0	0	0	0	0	0	0	0	103	214	0	0	0	0	9	15	0	0	112	229
8	Inspektorati Policor i Kosovës	0	0	0	0	0	0	2	2	245	500	1	1	0	0	0	0	0	0	248	503
9	E pranuar në kompetencë	0	0	1	1	3	9	6	18	11	19	5	6	1	1	30	39	0	0	57	93
10	Njësia për Inteligjencë Financiare	0	0	1	1	1	1	0	0	459	651	5	12	0	0	1	1	0	0	467	666
11	Organi i administratës komunale	0	0	0	0	0	0	0	0	21	24	0	0	0	0	2	2	0	0	23	26
12	Policia e Kosovës	3	24	100	129	20	47	6	16	347	604	83	173	34	51	429	444	0	0	1022	1488
13	Prokurori me vetiniciativë	0	0	0	0	0	0	0	0	19	21	0	0	0	0	2	4	0	0	21	25
14	Të tjera (qytetari,)	0	0	0	0	1	5	5	18	39	120	1	1	0	0	1	2	0	0	47	146
15	Titullari i pronës - OP të dëmtuar	0	0	0	0	0	0	0	0	10	29	0	0	0	0	3	3	0	0	13	32
16	Auditori Gjeneral	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjithsej:		3	24	102	131	25	62	21	61	1497	2677	101	200	35	52	532	566	0	0	2316	3773

Figura 45

Policia e Kosovës ka parashtruar sasinë më të madhe të Informatave PPN (44.13%) dhe personave (39.44%), gjatë pesë viteve (2013-2017), ndërsa asnjë Informatë PPN nuk rezulton të jetë e parashtruar nga Auditori Gjeneral. Asnjë Informatë PPN nuk është parashtruar gjatë pesë viteve (2013-2017), për veprën e pretenduar penale të Nxjitjes së urrejtjes (shih figurën 46).




Figura 46

KONKLUZIONE

Në fillim theksojmë se nga të dhënat e pasqyruara në këtë raport rezulton se themelimi dhe funksionalizimi i Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional ka rezulton me sukses në identifikimin, verifikimin dhe harmonizimin e të dhënave për veprat penale karakteristike, dhe në këtë kontekst të arriturat lidhur me performancën në trajtimin e lëndëve do të pasqyrohen në vazhdim.

1. Konstatohet se përgjatë pesë viteve (2013-2017), të funksionimit të Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional janë pranuar 7751 kallëzime penale për të gjitha grupet e veprave penale karakteristike ndërsa gjatë periudhës së njëjtë janë proceduar 6461 kallëzime penale, apo 83.36%. Në këtë kontekst theksojmë se gjatë këtyre pesë viteve, kishte rritje të vazhdueshme të efikasitetit në procedimin (sasior), e kallëzimeve penale në raport me kallëzimet penale të pranuar, respektivisht në vitin 2013 përqindja e procedimit të kallëzimeve penale ishte 70.32%, në vitin 2014 ishte 76.13%, në vitin 2015 ishte 82.88%, në vitin 2016 ishte 89% dhe në vitin 2017 është ngritur në 91.57%. Nga tërësia e kallëzimeve penale të proceduara gjatë pesë viteve rezulton se numrin më të lartë e përbëjnë kallëzimet penale për veprat penale të Drogave me 2257 kallëzime penale të proceduara, pastaj të Korrupsionit me 2094 kallëzime penale të proceduara dhe Krimeve ekonomike me 1632 kallëzime penale të proceduara.
2. Konstatohet se ngarkesa me lëndë (kallëzime penale), për veprat penale karakteristike kishte rritje të vazhdueshme nga viti 2013 deri në vitin 2016, ndërsa në fund të vitit 2017 ngarkesa me lëndë është zvogëluar për 33 kallëzime penale më pak se në vitin paraprak. Në këtë kontekst theksojmë se në fund të vitit 2017, vetëm tre grupe të veprave penale kishin rritje të ngarkesës me kallëzime penale: Drogat me rritje prej 117 kallëzimeve penale; Trafikimi me njerëz me rritje prej 9 kallëzimeve penale dhe Krimeve organizuar me rritje prej 3 kallëzimeve penale, ndërsa të gjitha grupet tjera të veprave penale kanë pësuar zvogëlim të ngarkesës me lëndë.
3. Konstatohet se përgjatë pesë viteve (2013-2017), të funksionimit të Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional janë pranuar 13129 raste për persona të përfshirë në kallëzimet penale për të gjitha veprat penale karakteristike, ndërsa gjatë periudhës së njëjtë janë proceduar 11975 raste për persona, apo 91.21%. Sipas kriterit të performancës sipas viteve, rezulton se në vitin 2013, janë proceduar 72.27% të rasteve të pranuar për persona, në vitin 2014 janë proceduar 82.99%, në vitin 2015 janë proceduar 88.07%, në vitin 2016 janë proceduar 104.41%⁴ dhe në vitin 2017 janë proceduar 103.66%. Nga tërësia e rasteve të proceduara për persona gjatë pesë viteve rezulton se numrin më të lartë e përbëjnë Korrupsioni me 4746 persona, Drogat me 3383 persona dhe Krimeve ekonomike me 2029 raste të proceduara për persona.
4. Konstatohet se ngarkesa me lëndë (raste për persona), për veprat penale karakteristike kishte rritje të vazhdueshme nga viti 2013 deri në vitin 2015, ndërsa në fund në vitin 2016 është zvogëluar me 149 raste për persona, si dhe në vitin 2017 është zvogëluar për 512 raste për persona në raport me ngarkesën me persona në vitin paraprak. Në këtë kontekst theksojmë se në fund të vitit 2017, vetëm tre grupe të veprave penale kishin rritje të ngarkesës me persona: Drogat me rritje prej 168 rasteve për persona; Shpërlarja e parasë me rritje prej 17 rasteve për persona dhe Kontrabanda me migrant me rritje prej 5

⁴ Tejkalmimi i kuotës sëmbi 100% të rasteve të proceduara për persona në raport me rastet e pranuar gjatë viteve respektive, i adresohet rasteve të trashëguara nga periudhat paraprake apo nga ngarkesa me lëndë (rastet për persona), të cilat si të paproceduara barten në vitin vijues dhe janë kategori tjetër nga kategoria e rasteve të pranuar si rastet të reja në vitet respektive.

rasteve për persona në raport me ngarkesën me persona në vitin paraprak, ndërsa të gjitha grupet tjera të veprave penale kanë pësuar zvogëlim të ngarkesës me rastet për persona.

5. Konstatojmë se subjektet e ndryshme gjatë pesë viteve (2013-2017), kanë parashtruar nëpër prokurori gjithsej 7751 kallëzimet penale me 13129 persona të përfshirë në veprat penale karakteristike, prej të cilave numrin më të lartë e përbëjnë lëndët për veprat penale të Drogave me 3106 kallëzime penale me 4455 persona, Korrupsioni me 2232 kallëzime penale me 4506 persona dhe Krimet ekonomike me 1815 kallëzime penale me 2386 persona. Nga tërësia e kallëzimeve penale të proceduara, gjatë pesë viteve, nëpër prokurori rezulton se Policia e Kosovës ka parashtruar numrin më të lartë të tyre, respektivisht 5936 kallëzime penale apo 76.58% dhe 9658 raste për persona apo 73.56%, ndërsa numrin më të ulët rezulton të ketë parashtruar Agjencioni Kosovar i Pronës me gjithsej 3 kallëzime penale apo 0.04%, dhe 7 persona apo 0.05%.
6. Konstatojmë se nga tërësia prej 11975 rasteve të proceduara për persona të përfshirë në kallëzimet penale për veprat penale karakteristike, gjatë pesë viteve (2013-2017), sipas kriterit të mënyrës së procedimit rezulton se numrin më të lartë e përbëjnë ngritja e aktakuzave⁵ për 7176 person apo 59.92%, hudhja e kallëzimeve penale për 2438 persona apo 20.36% dhe pushimi i hetimeve për 2303 persona apo 19.23%. Sipas kriterit të llojit të veprës penale, rezulton se numri më i lartë i hudhjeve të kallëzimeve penale për persona i adresohet veprës penale të Korrupsionit (1383 raste për persona). Poashtu numri më i lartë i pushimit të hetimeve i adresohet veprës penale të Korrupsionit me 1329 pushime të hetimeve. Ndërsa, numri më i lartë i aktakuzave të ngritura i adresohet veprës penale të Drogave me gjithsej 3024 aktakuza për persona, pasuar nga 2010 aktakuzat e ngritura për veprat penale të Korrupsionit. Sipas kriterit të Prokurorisë rezulton se prokuroria Themelore në Prishtinë për 5 vite ka proceduar numrin më të lartë me 3564 raste për persona, apo 29.76% (në kuadër të të cilave 1763 persona për Korrupsion, 872 persona për Droga dhe 651 persona për Krime ekonomike). Ndërsa numrin më të ulët të procedimit të rasteve për persona për 5 vite, rezulton të ketë Prokuroria Themelore në Gjakovë me 611 raste për persona, apo 5.10% (në kuadër të të cilave 259 persona për Korrupsion, 193 persona për Droga dhe 107 persona për Krime ekonomike). Sipas kriterit të aktakuzave të ngritura theksojmë se në vitin 2017 janë ngritur 2014 aktakuza që në raport me vitin 2016 (1471 aktakuza), rezulton me ngritje të numrin të aktakuzave me 543 aktakuza me shumë se në vitin 2016 apo 36.91% (prej të cilave 1100 aktakuza apo 54.62%, i përkasin veprave penale të Drogave).
7. Konstatojmë se prokuroritë gjatë pesë viteve (2013-2017), kanë parashtruar 1884 kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit për personat e përfshirë në veprat penale karakteristike, prej të cilave Gjykatat kanë aprovuar 942 kërkesa apo 50%. Sipas kriterit të llojit të veprës penale rezulton se nga 916 kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit për personat e përfshirë në veprën penale të Drogave gjykatat kanë aprovuar 462 apo 50.44%, ndërsa nga 17 kërkesat për për caktimin e masës së paraburgimit për personat e përfshirë në veprat penale të Armëve, gjykatat nuk kanë aprovuar asnjë kërkesë.
8. Konstatojmë se nga 2067 rastet për persona për të cilët gjykata ka marrë vendim, rezulton se 1570 të akuzuar apo 76% janë shpallur fajtor, 224 të akuzuar apo 11% janë liruar, për 116 të akuzuar apo 6% gjykatat kanë hudhur aktakuzën para shqyrtimit

⁵ Ngritja e 7176 aktakuzave për persona i referohet mënyrave të procedimit të rasteve për persona: (1) Aktakuza për dhënien e urdhrit ndëshkimor (534 persona), (2) Aktakuza të drejtpërdrejta (1857 persona), dhe (3) Aktakuza pas zhvillimit të hetimeve (4785 persona).

gjyqësor dhe për 157 të akuzuar apo 7% është refuzuar aktakuza (105 atakuza të refuzuara apo 66.88% i përkasin veprave penale të Korrupsionit).

9. Konstatohet se nga 478 ankesat e prokurorëve (288 ankesa ndaj vendimit mbi dënimin dhe 190 ankesa për arsye tjera), Gjykata e Apelit ka aprovuar 25 prej tyre apo 5.23%. Theksohet se nga 478 ankesat e parashtruara në gjykatën e Apelit 238 ankesa apo 49.79%, i përkasin veprave penale të Korrupsionit.
10. Konstatohet se përgjatë pesë viteve (2013-2017), të funksionimit të Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional janë pranuar 2316 Informata PPN për të gjitha grupet e veprave të pretenduara penale karakteristike, ndërsa gjatë periudhës së njëjtë janë mbyllur 1707 Informata PPN, apo 73.70% (prej të cilave 1146 apo 67.14%, i përkasin veprave penale të Korrupsionit). Në këtë kontekst theksohet se vetëm në vitin 2017 është arritur të procedohen më shumë Informata PPN (743) në raport me numrin e Informatave të pranuar të reja (734), duke arritur kuotën prej 101.23%. Në këtë raport krahasimor (të pranuar të proceduara), rezulton se gjatë pesë viteve (2013-2017), prokuroria themelore në Gjilan ka kuotën më të lartë, 84.47% të Informatave PPN të mbyllura ndërsa kuotën më të ulët rezulton të ketë prokuroria themelore në Mitrovicë me vetëm 31.96%.
11. Konstatohet se ngarkesa me lëndë (Informata PPN), për veprat e pretenduara penale karakteristike, vetëm në vitin 2017 ka pësuar rënie për 66 Informata PPN në raport me vitin paraprak. Ngarkesën më të lartë në fund të vitit 2017 e përbëjnë 603 Informatat PPN për veprat e pretenduara penale të Korrupsionit, ndërsa theksohet se për veprën penale të Nxitjes së urrejtjes përgjatë pesë viteve nuk kishte ndonjë Informatë PPN të parashtruar nga subjektet parashtruese.
12. Konstatohet se përgjatë pesë viteve (2013-2017), të funksionimit të Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional nëpër prokurori janë pranuar 3773 raste për persona të përfshirë në Informatat PPN, për veprat e pretenduara penale karakteristike, ndërsa gjatë periudhës së njëjtë janë mbyllur 2684 raste për persona, apo 71.14%. Në vitin 2017 rezulton se për të vetmen herë (gjatë 5 viteve), është tejkaluar numri i rasteve të mbyllur për persona (1094) në raport me rastet e pranuar (1044) apo 104.79%. Theksohet se nga tërësia e 2684 rasteve të mbyllura për persona, 2020 raste apo 75.26%, i përkasin veprave të pretenduara penale të Korrupsionit.
13. Konstatohet se ngarkesa me lëndë (raste për persona në Informatat PPN), për veprat e pretenduara penale karakteristike për të vetmen herë ka pësuar rënie në vitin 2017, për 69 raste për persona në raport me vitin 2016, dhe se rritje të vetme kishin lëndët e kontrabandimit me migrant (1 person), Shpërlarja e parasë (16 persona) dhe Krimet ekonomike (19 persona). Theksohet se nga tërësia e ngarkesës me 1628 persona në fund të vitit 2017, prej tyre 1102 persona apo 67.69%, i përkasin veprave të pretenduara penale të Korrupsionit prej të cilave 754 raste për persona i përkasin prokurorisë themelore në Prishtinë.
14. Konstatohet se subjektet e ndryshme gjatë pesë viteve (2013-2017), kanë parashtruar nëpër prokurori gjithsej 2316 Informata PPN me 3773 persona të përfshirë në veprat e pretenduara penale karakteristike. Policia e Kosovës ka parashtruar numrin më të lartë të lëndëve, respektivisht 1022 Informata PPN apo 44.13% me 1488 persona apo 39.44%. ndërsa numrin më të ulët rezulton të ketë parashtruar Autoriteti Pyjor i Kosovës, me gjithsej 1 Informatë PPN apo 0.04%, me 1 persona apo 0.03% (për veprën e pretenduar penale të Korrupsionit).

REKOMANDIME:

1. Këshilli Prokurorial i Kosovës të trajtojë problematikën e ngarkesës së madhe me kallëzime penale për veprat penale të Drogave, me qëllim të trajtimit të tyre me prioritet të theksuar nga ana e prokurorëve në të gjitha prokuroritë themelore.

Arsyetim: Këshilli Prokurorial i Kosovës, që nga viti 2013 ka krijuar dhe zbatuar plane për ngritjen e efikasitetit në trajtimin e lëndëve të Korrupsionit për shkak se të njëjtat përbënin nivelin më të lartë të lëndëve nga tërësia e veprave penale karakteristike, ndërsa në vitin 2016 dhe 2017 ka ndodhur një ndryshim shumë i madh (i parashikuar dhe sinjalizuar në KPK përmes raportit hulumtues për ngarkesën me lëndë)⁶. Në vitin 2015 lëndët e korrupsionit dhe drogave kishin përafërsisht numër të përafërt të kallëzimeve penale, ndërsa në vitin 2016 ka filluar ndryshimi, i cili konsiston se ngarkesa me lëndët e Korrupsionit ishte 447 kallëzime penale ndërsa veprat penale të Drogave përbënin tërësinë prej 828 kallëzime penale. Për më tej, në vitin 2017 ngarkesa me lëndët e Korrupsionit rezulton me 316 kallëzime penale, ndërsa ngarkesa me lëndët e Drogave rezulton me 1002 kallëzime penale dhe 1357 persona, prej të cilave numrin më të lartë rezulton të kenë prokuroria themelore në Prishtinë, me 604 kallëzime penale me 826 persona dhe prokuroria themelore në Mitrovicë me 144 kallëzime penale dhe 198 persona.

Rekomandim: Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bashkëpunim me kryeprokurorët e prokurorive Themelore të Prishtinës dhe Mitrovicës të përcaktohen për profilizimin e prokurorëve të cilët do të trajtojnë lëndët e Drogave me prioritet bazuar në një plan të përcaktuar të veprimit.

2. Këshilli Prokurorial i Kosovës të trajtojë çështjen e regjistrimit të lëndëve të Korrupsionit me kallëzime penale në regjistrin PPN.

Arsyetimi: Ngarkesa me Informata PPN për veprat penale të Korrupsionit është në rritje, respektivisht në fund të vitit 2017 kanë mbetur të pambyllura 603 Informata PPN me 1102 persona të përfshirë në veprat e pretenduara penale të Korrupsionit, prej të cilave në prokurorinë themelore në Prishtinë ngarkesa me këto lëndë rezulton me 330 Informata PPN dhe 611 persona. Meqenëse sistemi prokurorial ka prioritet luftimin e korrupsionit, dhe në këtë kontekst theksojmë se në fund të vitit 2017 kanë mbetur të paproceduara 316 kallëzime penale me 740 persona, në anën tjetër kemi të pambyllura 603 Informata PPN me 1102 persona, prej të cilave 444 Informata PPN me 719 persona janë pranuar nëpër prokurori në vitin 2017 si lëndë të reja. Hipoteza se disa parashtrues të lëndëve (informatave PPN për Korrupsion), në prokurori nuk arrijnë të përfshijnë të gjitha të dhënat e nevojshme të cilat do të përmbushnin kriterin e regjistrimit të këtyre lëndëve në regjistrin PP, nuk qëndron për faktin se vetëm 20 Informata PPN me 34 persona janë proceduar në Prokurori nga qytetarët, respektivisht:

- I dëmtuari; 18 Informata PPN me 32 persona
- Titullari i pronës: 2 Informata PPN me 2 persona.

Ndërsa 424 Informata PPN me 685 persona janë proceduar në prokurori nga Institucionet, respektivisht:

- Agjencioni Kundër Korrupsionit: 2 Informata PPN me 2 persona,

⁶ Hulumtim: Identifikimi i ngarkesës me lëndë, përmes analizimit të të dhënave mbi gjendjen e veprave penale karakteristike 2013-2016, me qëllim të planifikimit të veprimeve për ngritjen e efikasitetit në zgjidhjen e lëndëve të reja. Për më tej shih: <http://www.kpk-rks.org/raporte/258/rmp-2017/258>

- Administrata Tatimore e Kosovës: 1 Informatë PPN me 7 persona,
- Eulex-i: 86 Informata PPN me 166 persona,
- Inspektoriati Policor i Kosovës: 79 Informata PPN me 128 persona,
- Njësia e Inteligjencës Financiare: 189 Informata PPN me 257 persona,
- Organet e Administratës Komunale: 7 Informata PPN me 8 persona,
- Policia e Kosovës: 55 Informata PPN me 106 persona,
- Prokurori me vetiniciativë: 6 Informata PPN me 7 persona.

Rekomandim: Këshilli Prokurorial i Kosovës të themeloj një Komision me detyrë që të verifikoj fizikisht të gjitha lëndët PPN të Korrupsionit nëpër të gjitha prokuroritë të cilat trajtojnë këto lëndë, dhe në rast të identifikimit të kallëzimeve penale në Informatat PPN, të njëjtat së bashku me prokurorët e lëndëve t'i zhvendos nga regjistri PPN në regjistrin PP, duke plotësuar edhe informatat në bazën Krim/korr lidhur me këto zhvendosje. Për më tej, komisioni të procedoj në KPK një raport mbi të gjeturat dhe detyrat e realizuara.

Vërejtje: në vitin 2014, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka themeluar një komision të këtij lloji, i cili ka verifikuar të gjitha lëndët e Korrupsionit dhe pasi ka evidentuar problemet e kësaj natyre të njëjtat i ka zhvendosur në regjistrin PP, si dhe ka përgatitur raport 124 faqesh për KPK-në. Andaj me qëllim të rregullimit të kësaj çështje, Këshilli mund të themeloj dhe obligoj një komision me të njëjtën natyrë të detyrave.

@ KPK 2018

Autor: Koordinatorinacional i Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional

Pronësia: Këshilli Prokurorial i Kosovës